



103

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE  
SEKTORI I INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË PYJEVE E KULLOTAVE

Nr 8555 prot.

Lezhë, më: 26-05-2026

**PROJEKT-V E N D I M**

NR. —, Datë 26-05-, 2026

**PËR**

**MIRATIMIN E MODELIT TË GJOBËS PËR KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE  
NË FONDIN PYJOR E KULLOSOR**

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", nw ligjin nr.49/2017" për disa ndryshime dhe ndalesa në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për Fondin Kullosor" pas shqyrtimit të dokumentacionit, Kryetari i Bashkisë:

**PROPOZON:**

1. Miratimin e modelit të gjobës për kundravajtjet administrative në fondin pyjor e kullosor, sipas modelit që i bashkangjitet këtij Projekt-Vendimi.
2. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

**KRYETARI**  
Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE  
SEKTORI I INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË PYJEVE E KULLOTAVE

Nr 8555/prot.

Lezhë, më: 26-05.2026

### RELACION

## PËR MIRATIMIN E GJOBËS PËR KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE NË FONDIN PYJOR E KULLOSOR

### Të nderuar Këshilltarë!

Në lidhje me Projekt-vendimin për miratimin e modelit të gjobës të parashikuar në nenin 35 të Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” ku përcaktohet se struktura inspektuese në bashki ndërmarrin masë administrative ndaj kundërvajtësve në fondin pyjor e kullosor nëpërmjet inspektorëve pyjor.

Neni 38 i po këtij ligji përcakton procedimin administrativ ku inspektori:

- Mban proces-verbal
- Dokumenton shkeljen
- Vendos e gjobën në bazë të shkeljes së kryer

Miratimi i këtij modeli është i nevojshëm për:

- Standartizimin e procedurës së evidentimit të shkeljeve në fondin pyjor e kullosor.
- Dokumentimin ligjor të kundërvajtjeve administrative.
- Rritjen e efijencës në ushtrimin e kontrollit dhe inspektimit në fondin pyjor.
- Garantimin korrekt të masave administrative.
- Përbushjen e detyrimeve funksionale të inspektorëve pyjor, sipas legjislacionit në fuqi.

Modeli i propozuar i gjobës sipas ligjit do të përmbajë të dhëna mbi:

- Nr. Serial.
- Identitetin e kundërvajtësit.
- Përshkrimin e shkeljes.
- Vendin dhe kohën e konstatimit.
- Bazën ligjore.

- Masën Administrative.
- Të dhënat e inspektorit.
- Nënshkrimet përkatëse.

Ky dokument do të përdoret nga inspektorët e pyjeve dhe kullotave gjatë ushtrimit të kontrollit në fondin pyjor e kullosor, në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga ligji i sipërcituar. Sipas nenit 38 të Ligjit nr.57/2020, inspektorët kanë të drejtë të mbajnë proces – verbal, të dokumentojnë shkeljet dhe të vendosin masën administrative.

Kërkojmë miratimin e modelit të gjobës sipas modelit bashkangjitur Projekt-Vendimit për t'u përdorur nga Sektori i Inspektimit Pyjeve e Kullotave pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë.

Hartoi relacionin  
Inxh. Vesar GEGA



PËRGJEGJËSI  
Alfred PEPA



DREJTORI  
Paulin GJERGJI



KRYETARI  
Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

**DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE  
SEKTORI I INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË PYJEVE E KULLOTAVE**

Nr. Serie 0000000

**PROCESVERBAL – GJOBË ADMINISTRATIVE**

Në bazë të ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, sot më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/20\_\_\_\_, nga Inspektori i Pyjeve: **Emër Mbiemër:** \_\_\_\_\_  
Detyra: \_\_\_\_\_ u konstatua kjo kundërvajtje në fondin pyjor:

**TË DHËNAT E KUNDËRVAJTËSIT**

Emër Mbiemër: \_\_\_\_\_

Atësia: \_\_\_\_\_

Datëlindja: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Nr. ID: \_\_\_\_\_

**VENDI I KONSTATIMIT**

Njësia Administrative: \_\_\_\_\_

Fshati / Ekonomia pyjore: \_\_\_\_\_

Ngastra: \_\_\_\_\_

Koordinatat (nëse ka): \_\_\_\_\_

**PËRSHKRIMI I SHKELJES**

Më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/20\_\_\_\_, u konstatua se shtetasi i sipërpërmendur ka kryer këtë shkelje në fondin pyjor: \_\_\_\_\_

**BAZA LIGJORE**

Shkelja përbën kundërvajtje administrative sipas pikës \_\_\_\_gërma\_\_\_\_ neni \_\_\_\_ të ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”.

**MASA ADMINISTRATIVE**

Vendoset masë administrative me gjobë në vlerën: \_\_\_\_\_ lekë (me fjalë) \_\_\_\_\_

Si dhe:

1. Sekuestrim i materialit drusor, lloji, sasia m<sup>3</sup> \_\_\_\_\_
2. Sekuestrim i mjetit: \_\_\_\_\_
3. Masa të tjera: \_\_\_\_\_

**VËREJTJE** \_\_\_\_\_

Procesverbal i mbajt në \_\_\_\_ kopje dhe iu komunikua personit të konstatuar në vend.

**KUNDËRVAJTËSI**

\_\_\_\_\_  
Emër, Mbiemër, Firmë

**INSPEKTORI I PYJEVE**

\_\_\_\_\_  
Emër, Mbiemër, Firmë